

**VENDIM**  
**Nr.223, datë 1.8.2011**

**PËR VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR**  
**“TV Durrësi”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

|                |                 |
|----------------|-----------------|
| Endira Bushati | kryetare        |
| Alban Karapici | zëvendëskryetar |
| Suela Musta    | anëtare         |
| Sami Neza      | anëtar          |
| Gent Ibrahim   | anëtar          |
| Zylyftar Bregu | anëtar,         |

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi çështjen e vlefshmërisë së licencës së subjektit televiziv privat vendor “TV Durrësi”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 33 pika 1 dhe 3, neni 34 pika 4 dhe neni 137/3 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”.

**VËREN SE:**

KKRT-ja me vendimin nr.484, datë 17.7.2006, ka licencuar shoqërinë “Tv Durrësi” sh.p.k., për televizionin privat vendor “Tv Durrësi”, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat vendor, në fushën e transmetimeve televizive analogjike tokësore për një periudhë prej 5 vjetësh, për të mbuluar me sinjal qytetet Tiranë dhe Durrës.

Vendimi i KKRT-së, për dhënie licence ka hyrë në fuqi në datën 28.7.2006 dhe në datën 28.7.2011 ka përfunduar afati i licencës së këtij subjekti. Nga verifikimi i bërë në zyrën e arkivës dhe protokollit rezulton se subjekti nuk ka depozituar aplikim për rinovimin e licencës.

Sipas nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, “...Kërkesa për rinovimin e licencës bëhet 90 ditë përpara afatit të përfundimit të saj...”

Ndërsa neni 33 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, parashikon se:

“Licenca bëhet e pavlefshme kur:

1. Mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar...”

Sa më sipër, rezulton se subjekti nuk ka paraqitur kërkesë për rinovimin e licencës dhe nuk ka depozituar aplikimin përkatës për rinovimin e saj, megjithëse është detyrim ligjor që 90 ditë para përfundimit të licencës subjekti të dorëzojë kërkesën përkatëse.

Nga ana tjetër, me vendimin nr.189, datë 22.10.2010, KKRT-ja ka vendosur heqjen e licencës së subjektit televiziv privat vendor, pasi ky subjekt megjithëse është licencuar që në vitin 2006, nuk kishte dalë ende në transmetim.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, neni 34, pika 4, germa “a”:

“Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka të drejtë të heqë licencën e transmetimit kur:...4. Nuk ka filluar transmetimin pas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie licence për një periudhë kohe:

a) 270 ditë në transmetimet e televizioneve vendore...”

Sipas pikës 2 të vendimit të sipërcituar, subjekti kishte të drejtën e paraqitjes së pretendimeve të tij brenda një afati prej 30 ditësh. Me shkresën nr.6/1 prot., datë 26.11.2010, subjekti ka paraqitur ankim administrativ kundër heqjes së licencës së “Tv Durrësi”, duke theksuar se nga ana e këtij subjekti është transmetuar në mënyrë numerike, në funksion të formatit DVB-H. Subjekti pretendon se kur ka filluar transmetimet në teknologjinë numerike,

mungonte kuadri ligjor dhe për përfundim kërkon revokimin e vendimit nr.189, datë 22.10.2010 të KKRT-së.

Konkretisht subjekti pretendon se:

“...Kanali i transmetimit për të cilin jemi licencuar (kanali 29, banda UHF) ka qenë përherë i zënë nga shërbimi RF për të gjithë periudhën nga fillimi i transmetimit disa vite më parë e deri më sot...Pavarësisht kufizimeve në licencën tonë për formatin e transmetimit, ambicia jonë për të gjetur rrugët e reja të biznesit në fushën mediatike, na detyroi të rrezikonim duke investuar në këtë teknologji...Mendoj se është vendim jo i drejtë, i cili bazohet në faktin e mostransmetimit në teknologjinë analoge, dhe nuk merr parasysh faktin që frekuenca e dhënë në përdorim në bazë të licencës, është shfrytëzuar maksimalisht...Me keqardhje një mosrespektim të kërkesave të nenit 137, paragrafi i dytë, të ligjit nr.8410, i cili përcakton se: “KKRT-ja përcakton shkeljet konkrete, të cilat ndëshkohen nga sanksionet e përcaktuara në këtë nen, duke zbatuar fillimisht si rregull sanksionin e paralajmërimit. “Fatkeqësisht, KKRT-ja është shmangur nga kjo kërkesë e ligjit, duke sanksionuar subjektin tonë drejtpërdrejt...”

Lidhur me pretendimet e mësipërme, KKRT-ja konstaton se janë të pambështetura. Kanali i transmetimit 29 UHF, ka qenë në dispozicion të këtij subjekti, sipas licencës së miratuar nga KKRT-ja për transmetime analoge tokësore. Subjekti televiziv privat vendor “Tv Durrësi” është autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat vendor, në fushën e transmetimeve analogjike tokësore, në përputhje me kushtet e kriteret e parashikuara në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Nga ana tjetër, subjekti është pajisur me licencën përkatëse në të cilën janë parashikuar struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifa. Subjekti televiziv privat vendor “Tv Durrësi”, në kundërshtim me ligjin dhe me licencën e miratuar nga KKRT-ja, nuk ka dalë në transmetim sipas kushteve të licencës, duke e shkelur atë. Me shkresën nr.874 prot., datë 23.8.2008 të KKRT-së, subjektit i është vënë në dukje se kanali 29 UHF, për të cilin subjekti është licencuar nuk bën pjesë në kanalet numerike të caktuara për Shqipërinë prej marrëveshjes së nënshkruar në Konferencën Rajonale të Radiokomunikacioneve “Për planifikimin e shërbimit të transmetimeve numerike në pjesë të rajoneve 1 dhe 3 në bandat e frekuencave 174-230 MHz dhe 470-862 MHz”.

KKRT-ja nuk ka lëshuar asnjë autorizim apo leje për eksperimentimin e transmetimeve numerike për subjektin “Tv Durrësi”.

Subjekti televiziv privat vendor “Tv Durrësi” gjatë veprimtarisë së tij ka funksionuar duke shkelur kushtet e licencës së miratuar. Subjekti ka emetuar sinjal numerik (digjital) pa autorizimin e KKRT-së, ndërkohë që nuk ka njoftuar asnjëherë për ndryshime të skemës apo parametrave teknikë të transmetimit, ndërkohë që është licencuar për transmetime televizive analogjike tokësore. Subjekti ka transmetuar 16 programe që hynin në paketën programore të Digitalb Mobile, në të cilat nuk është përdorur logoja e subjektit “Tv Durrësi”.

Në mbështetje të nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, “I licencuari detyrohet të njoftojë Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit për çdo ndryshim të të dhënave...ose për mosplotësimin e kushteve të caktuara në licencë dhe arsyet përkatëse, paraprakisht dhe në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve...”

Nga ana tjetër, me miratimin e ligjit nr.9742, datë 28.5.2007 “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë”, i është hapur rruga transmetimeve numerike. Neni 3 i ligjit, parashikon se KKRT-ja jep licenca për ndërtim dhe shfrytëzim rrjetesh numerike tokësore të transmetimit, dhe sipas pikës 2 të këtij neni: “2. Rrjetet numerike tokësore shfrytëzojnë vetëm frekuencat e përcaktuara për përdorim numerik”. Rezulton se subjekti televiziv privat vendor “Tv Durrësi” ka filluar transmetimet numerike pa u pajisur me licencën përkatëse, por duke shfrytëzuar një kanal transmetimi të miratuar për transmetime analoge.

Arsyetimi i subjektit se kanali 29, në të cilin subjekti është autorizuar të transmetojë ka qenë përherë i zënë nuk qëndron pasi nga ana e subjektit nuk është dorëzuar asnjëherë që nga

momenti i licencimit ndonjë ankesë lidhur me shfrytëzimin e kanalit. Madje në të kundërt nga sa pretendohet, nga ana e subjektit është vepruar tej të drejtave që burojnë nga licenca e miratuar e transmetimit, duke përdorur një format transmetimi të ndryshëm nga ai për të cilin është licencuar.

KKRT-ja konstaton se përveç faktit që subjekti nuk ka paraqitur interes për rinovimin e licencës, nuk ka qenë i rregullt në zbatimin e ligjit gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës.

#### PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, neni 33 pika 1 dhe 3, neni 34 pika 4 dhe neni 137/3 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”,

#### VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën nr.083/TVL të subjektit televiziv privat vendor “Tv Durrësi”.
  2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 1 muaji në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurave Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE  
**Endira Bushati**